



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. ²⁰²⁰ prot.

Vlorë me, 30/12 /2024

VENDIM

Nr 25 datë 24.12.2024

**"PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT TË VITIT
2025"**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2024, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 137/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020.
- Ligji nr.115 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" Mbi përdorimin e fondit për parafinancimin bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj.
- V.K.M. nr. 783 dh. 09.11.2016 "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020"
- VKM nr 765, datë 12.12.2022 "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Keshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2021, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III)
- VKM nr. 649, date 10.10.2022 "Për propozimin e projekt ligjit te vitit 2023"
- Udhëzimi i MFE nr.31 datë 18.11.2022 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDOSI:

1. Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2025 si më poshtë (në lekë)

A. TE ARDHURA GJITHESJT	209,772,100
I. Të ardhurat e veta	176,128,680
a) Të ardhura kuotë antarësisë	16,500,000
b) Të ardhura nga Shërbimet	900,000
c) Të ardhura granti i pakushtëzuar viti 2025	66,510,000
d) Të ardhura (Grant i trashëguar) nga viti 2024	55,000,000
e) Të ardhura të trashëguar nga viti 2024 (kap) 5	37,000,000
f) Të ardhura jasht limitit të trashëguar kap 6	218,680
II. Grant i Kushtëzua (deleguara)	33,643,420
a) DAMT	13,500,000
b) Qendra Psiko "Sociale Vatra"	20,143,420
B. SHPENZIME GJITHESJ	209,772,100
Shpenzimet e veta	176,128,680
I. Shpenzime nga Granti i pa kushtëzuar	121,510,000
Nga këto	
a) Paga (600)	21,000,000
b) Sigurime Shoqërore + Shendetësore (601)	3,300,000
c) Shpenzime Operative (602)	22,243,418
d) Trasferta të brendshme Shoqata e të Verbërve, Qarqe, etj	10,458,500
e) Fond i vecante (609)	1,000,000
f) Investime (231)	63,308,082
2. Shpenzime nga të ardhurat Kap (5).	54,618,680
Nga këto:	
a) Shpenzime Operative (602)	16,256,582
b) Trasferta të brendshme Shoqata e të Verbërve, Qarqe, etj	10,000,000
c) Transferta Eurorajonet (605)	500,000
d) Investime (230/231)	27,862,098



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

3. Shpenzime nga Granti kushtëzuar (Deleguara)	33,643,420
1. DAMT	13,500,000
Nga këto:	
a) Paga (600)	11,000,000
b) Sigurime Shoqërore + Shendetësore (601)	2,000,000
c) Shpenzime Operative (602)	500,000
2. Qendra Psiko-Sociale Vatra (606)	20,143,420

2. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut brenda Institucionit.

3. Përgjegjësi i Financ - Buxhetit pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuar nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Grupi i punës:

Harallamb Pandehi
Anisa Hyseni
Mauricio Pashaj
Alma Myrtaj
Blerina Lala
Anisa Shametaj
Ilda Lamaj
Muhedin Bego



Ervis MOÇKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E KËSHILLIT TË
QARKUT PËR VITIN 2025

Projekt-buxheti i Këshillit të Qarkut për vitin 2025

Projekt-buxheti i paraqitur për miratim përfshin dy **komponentët kryesorë** të tij:

1. **Të ardhurat vendore**
2. **Shpenzimet për vitin 2025.**

të cilat synojnë të mbështesin politikën zhvillimore dhe të promovojnë vizionin strategjik të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Hartimi i projekt-buxhetit për vitin 2025 përbën një proces kyç për administratën e Këshillit të Qarkut, pasi ky dokument synon të adresojë detyrimet ligjore dhe objektivat strategjike të qeverisjes vendore në nivel rajonal, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë do të shërbejë si një instrument për:

- **Disiplinimin e veprimtarisë financiare,**
- **Menaxhimin efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve,**
- **Mbështetjen e iniciativave të reja zhvillimore dhe projekteve.**

Prioritetet e projekt-buxhetit për vitin 2025:

1. **Programimi dhe përmirësimi analitik** i zërave të buxhetit, përmes detajimit të shpenzimeve sipas destinacionit.
2. **Monitorimi i vazhdueshëm** i shpenzimeve në raport me realizimin e të ardhurave.
3. **Harmonizimi i politikave rajonale** me politikën shtetërore në përputhje me funksionet e përcaktuara për Këshillin e Qarkut.

Planifikimi dhe përmbajtja e buxhetit

Buxheti i Këshillit të Qarkut për vitin 2025 përmban:

- Misionin dhe objektivat e njësisë vendore,
- Programet dhe veprimtarinë specifike,
- Politikën dhe objektivat e zhvillimit,
- Shpenzimet kapitale, projektet dhe standardet e shërbimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Ky buxhet paraqitet në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku të gjitha njësitë shpenzuese janë të detyruara të përgatisin buxhetin sipas programeve të miratuara.

Shpenzimet dhe menaxhimi i fondeve

1. Buxheti i miratuar depozitohet në degën e thesarit, sipas rregullave dhe formateve të sistemit AFMIS.
2. Deri në miratimin e buxhetit përfundimtar, shpenzimet mujore nuk mund të kalojnë 1/12 e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të realizuara, bazuar në autorizimin e kryetarit të Këshillit të Qarkut.

Transparenca dhe pasqyrimi i fondeve

- Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar të vitit 2024 do të regjistrohen në kapitullin 01 për t'u bashkuar me transfertat për vitin 2025.
- Në përputhje me nenin 41, pika 2, gërma b të ligjit nr. 139/2015, të gjitha transfertat e kushtëzuara janë pjesë përbërëse e buxhetit.

Buxheti i Këshillit të Qarkut është unik, duke pasqyruar:

- Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet sipas burimit të financimit (kap. 01 dhe kap. 05).
- Kufijtë maksimalë të shpenzimeve sipas titullit, kapitullit dhe artikullit, duke ruajtur balancën midis arkëtimeve dhe pagesave.

Ky projekt-buxhet synon të përmbushë objektivat financiare dhe zhvillimore të Këshillit të Qarkut Vlorë, duke garantuar një planifikim të qëndrueshëm, transparent dhe të përgjegjshëm për vitin 2025.

Treguesit kryesorë të buxhetit të vitit 2025

A. Të Ardhurat

Burimet kryesore të të ardhurave për buxhetin e vitit 2025 të Këshillit të Qarkut Vlorë janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

1. Granti i pakushtëzuar nga buxheti i shtetit, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
2. Kuota e anëtarësisë, e përcaktuar në bazë të vendimeve për bashkëpunimin ndërinstitutional në nivel rajonal.
3. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve, përfshirë:
 - o Urbanistikën,
 - o Drejtorinë e Administrimit të Tokës, etj.

Totali i të ardhurave buxhetore për vitin 2025 është parashikuar në shumën 176,128,680 lekë, pa përfshirë funksionet e deleguara nga niveli qendror.

Nr	Emërtimi i të Ardhurave	2025
I.	Të ardhura nga tarifa Administrative	900.000
1	Kërkesë për dokumenta Zyrtare nga Arkivi	120.000
2	Tarifa të tjera	125.000
3	Vërtetim pronësie pas vitit 1946	120.000
4	Konfirmim zëri Kadastral	90.000
5	Konfirmim i vërtetimeve për ndihmë ekonomike dhe përkrahje sociale	120.000
6	Harta skica planimetrike kadastrale	90.000
7	Vërtime për kategorizimin e tokës, sipas bonitetit	100.000
8	Vërtimi me të dhëna nga formulari nr. 6	80.000
9	Tarifa për shërbime të tjera administrative	55.000
IV	Te ardhurat te tjera	175,228,680
1	Të ardhura të trashëguara nga 2024(05)	37,000,000
3	Të ardhura nga transferat e pakushtëzuar e përgjithshme	66,510,000
4	Të ardhura jashtë limitit të trashëguar kap 6	218,680
5	Të Ardhura nga kuota e antaresise	16,500,000
6	Të ardhura nga grant i trashëguar 2024	55,000,000
	Totali	176,128,680
	Granti i kushtëzuar per funksionet e deleguara DAMT & Vatra	33,643,420
	DAMT	13,500,000
	Qendra Psiko Sociale Vatra	20,143,420



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Totali i buxhetit

209,772,100

Parashikimi i të ardhurave për buxhetin e vitit 2025

Treguesi kryesor në parashikimin e të ardhurave është **kuota e anëtarësisë së bashkive përbërëse në nivel qarku**, e cila përcaktohet në përputhje me:

- **Nenin 38, pika 3 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar**, ku citohet:

"Qarku financohet nga kuota e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak."

Për realizimin e kësaj të ardhure:

- Në mbështetje të udhëzimit të buxhetit, Këshilli i Qarkut do të miratojë një Akt-Marrëveshje midis Bashkive dhe Këshillit të Qarkut për derdhjen e kuotës së anëtarësisë.
- Ky Akt-Marrëveshje do të garantojë që kjo e ardhur të derdhet sipas përqindjeve të miratuara në Këshillat përkatës të Bashkive.

Rëndësia e kuotës së anëtarësisë: Kuota e anëtarësisë është një nga burimet kryesore të të ardhurave, e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e buxhetit të qarkut për vitin 2025.

Të ardhurat e tjera janë parashikuar duke marrë në konsideratë nivelin e realizimit të vitit të kaluar, duke siguruar një parashikim realist dhe të qëndrueshëm për buxhetin e ardhshëm.

Ky parashikim bazohet në:


- Parimet e menaxhimit të financave publike sipas ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Kërkesat për transparencë dhe eficiencë në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave vendore në nivel rajonal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË



Paraqitja grafike e të ardhurave:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË



Shpenzimet

- ❖ **Totali i shpenzimeve është parashikuar në 209,772,100 lekë në total.**

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve korrente në buxhetin e vitit 2025 janë si më poshtë:

1. Shpenzimet nga Granti pa kushtesuar	121,510,000
Paga (600)	21,000,000
Sigurime shpëtorore + Shëndetësore (601)	3,500,000
Shpenzime Operative (602)	22,243,418
Transferita të Brendshme Shqiptare e të Verberve, Qarkut etj (604)	10,458,500
Fondi i Vecant (609)	1,000,000
Investime (231)	63,308,082


2. Shpenzimet nga të ardhurat kapitale (5),(6)	54,618,680
Shpenzime Operative (602)	16,236,382
Transferita të Brendshme Shqiptare e të Verberve, Qarkut etj (604)	10,000,000
Transferita Evropiane (605)	500,000
Investime (230/231)	27,862,098

3.Shpenzime nga Granti i Kushtesuar	33,643,420
DAMI	13,500,000
Ylira	20,143,420





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Grafikisht:






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE



♦ **Shpenzime për personelin.**

Numri i punonjësve për vitin 2025 është parashikuar të jetë **13**, njësoj si në vitin 2024. Ky parashikim është bërë në përputhje me nenin 15, pika 4 të ligjit nr. 97/2023 "Për Buxhetin e Vitit 2024", i cili përcakton kufizimin e personelit administrativ të Këshillit të Qarkut deri në 10 punonjës (përfshirë të zgjedhurit).

Në një moment të dytë, ky numër do të rishikohet dhe do të reflektojë çdo ndryshim që rrjedh nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke respektuar dispozitat përkatëse të legjislationit të miratuar për vitin 2025.

Fondi i shpenzimeve për personelin (paga dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore) për vitin 2025 është llogaritur për 13 punonjës, në shumën totale prej 24,500,000 lekë, që përbën **14% të buxhetit** të përgjithshëm, pa përfshirë funksionet e deleguara.

Fondi i Pagave 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

TOT		600	601
Shpenzime Paga dhe sigurime Admin	24,500,000	21,000,000	3,500,000
Paga dhe Sig Qendra VAlm	16,746,938	14,350,418	2,396,520
Paga Sig DAMT	13,000,000	11,000,000	2,000,000
TOT	54,246,938	46,350,418	7,896,520

Shpenzimet operative, të cilat përfshijnë:

- Pjesëmarrje në festivale dhe panaire,
- Dietat,
- Materiale për funksionimin e zyrave,
- Promovime,
- Shpërblyme për këshilltarët,
- Transportin,
- Mirëmbajtjen,
- Energjinë elektrike, ujin, postën, etj.,

zënë afërsisht 21.8% të buxhetit total, pa përfshirë funksionet e deleguara.

Ky parashikim është bërë duke marrë në konsideratë:

- Realizimet e vitit të kaluar dhe nevojat aktuale të funksionimit të Këshillit të Qarkut,
- Standardet e menaxhimit financiar sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efikase të burimeve buxhetore.

Emertimi	Mallra & Shërbime 2025
Shpërblym kryesia e qarkut	1,250,000
Kancelari	80,000
Materiale pastrimi	120,000
Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	276,000
Shtypshkrime	20,000
Furnizime materiale të përgjithshme	1,000,000

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati Kulturor "Lulëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkadlora.gov.al
E-mail: info@qarkadlora.gov.al
Tel: +355 32 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Broshura, Buletine, publikime profesionale	300,000
Kartolina, certifikata fresa Turizmi dok. Specifik	200,000
Shpenzime te tjera (tituj nderi)	300,000
Shpenzime telef. Fix, Cel, Internet miremb. faqja e Domain	700,000
Udhetim i brendshem	1,500,000
Udhetim jashte shtetit	1,500,000
Karburant dhe vaj Karb.600 lit/muaj -1200 + vaj 140	1,300,000
Pjese kembimi, goma, bateri	200,000
Sigurim i mjeteve te transportit	170,000
Te tjera trasporti Larje Makina	44,000
Shpenzime poste	100,000
Shpenzime per qiramarije ambjentesh zyra	600,000
Elektricitet	150,000
Shpenzime Uji	100,000
Shpenzime Gjyqi	200,000
Shpenzime te Pastrimit	770,000
Shpenzime per Komision Ad - Hoc	400,000
Shpenzim per pritje e percjellje,	100,000
Shpenzime Publikim per media	200,000
Sherbime te tjera Kontrate Sherbimi (lulet etj)	400,000
Shpenzime per mirembajtje Nderimore	50,000
Shpenzime per miremb, Aparate pajisje teknike	120,000
Shpenzime per mirembajtje te mjeteve te transportit	250,000
Shpenzime per miremb, te tjera etj.	100,000
Shpenzime per ekzekutim vendimeve gjyqesore per largim nga puna	1,000,000
Aktivitet Festa e Drashovices	800,000
Aktivitet Tetori Roze	1,200,000
Aktivitet Tradite, Kulture, Shije Delvinjote	1,200,000
Aktivitet Festivali Melodite qytetare	1,500,000
Aktiviteti i promovimit te qarkut (Vere+Ulliri, plateforme promovimi etj)	8,000,000
Aktivitet Festivali Folklorik i Kendojme Flamurit	3,000,000
Aktivitet, festivali "Sol International Music" bashkia Himare	1,500,000
Aktivitet "Color Wave", bashkia Himare	2,000,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Aktivitetet Christmas Market, bashkia Himarë	800,000
Hartimi i planit Social	5,000,000
TOTALI	38,500,000

» PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE OPERATIVE ANALITIK TË ART. (602) PER VITIN 2025

Për vitin 2025, shpenzimet operative për aparatën administrative janë parashikuar në shumën 38,500,000 lekë, që përbën 21.8% të buxhetit total, pa përfshirë funksionet e deleguara.

Shpenzimet operative

Shpenzimet për kancelari, shtypshkrime dhe materiale të përgjithshme janë planifikuar në vlerën 1,376,000 lekë, të bazuara në:

- Shpenzimet faktike të vitit 2024,
- Intensitetin e pritshëm të punës së administratës për vitin 2025.

Shpenzimet për publikime (broshura, buletine, kartolina, certifikata, ftesa, etj.) janë planifikuar në shumën 800,000 lekë.

Shpenzimet për shërbime utilitare:

- Energji elektrike: 150,000 lekë
- Uji: 100,000 lekë, bazuar në tarifën fikse.
- Shpenzimet për postën: 100,000 lekë, llogaritur mbi dërgesat institucionale dhe aplikimet e qytetarëve për formularë dhe kërkesa të tjera.

Shpenzimet për Domain, Telefon, etj janë planifikuar në vlerën 700,000 lekë, të ndara si më poshtë:

- Telefoni fikse: 48,000 lekë (8 linja x 500 lekë/muaj x 12 muaj),
- Internet për Vlorë, Sarandë dhe Delvinë: 432,000 lekë,
- Televizori për Zyrën e Kryetarit: 12,960 lekë,
- Mirëmbajtje faqe dhe hostim: 157,000 lekë,
- Domain: 50,000 lekë.

Totali: 700,000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

Shpenzimet për pastrim zyra dhe materiale pastrimi: 980,000 lekë, bazuar në pagën minimale për një punonjës me kontratë shërbimi me orar të plotë (8 orë/ditë).

Shpenzimet për transport dhe mirëmbajtje të mjeteve

1. Shpenzimet për karburant: 2,115,000 lekë, të bazuara në:
 - Konsumi vjetor prej 5,400 litrave naftë, me çmimin 181 lekë/litër.
 - Ndarja mujore e konsumit:
 - Mjeti Foristradë Hyundai: 350 litra/muaj.
 - Mjeti Foristradë Land Rover: 250 litra/muaj.
2. Shpenzimet për filtra dhe vaj: 100,000 lekë, të ndara si vijon:
 - Hyundai: 50,000 lekë,
 - Land Rover: 50,000 lekë.
3. Shpenzimet për pjesë këmbimi: 200,000 lekë (100,000 lekë për secilin mjet).
4. Shpenzimet për sigurim kasko dhe të thjeshtë: 170,000 lekë.
5. Shpenzimet për larje të mjeteve: 44,400 lekë.

Shpenzimet për udhëtime

- Udhëtime të brendshme: 1,500,000 lekë, bazuar në intensitetin e pritshëm të punës për vitin 2025.
- Udhëtime jashtë shtetit: 1,500,000 lekë, të nevojshme për ndjekjen e zhvillimeve në Eurorajone dhe përfitim të projekteve me donatorë të huaj.

Shpenzimet për mirëmbajtje

Shpenzimet për mirëmbajtje janë planifikuar në shumën **520,000 lekë**, të ndara si vijon:

- Mirëmbajtje institucionale: 50,000 lekë,
- Mirëmbajtje pajisjeve teknike (kompjuterë, printera, etj.): 120,000 lekë,
- Mirëmbajtje të tjera: 100,000 lekë,
- Mirëmbajtje të mjeteve të transportit: 250,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Shpenzimet për aktivitete

Totali për aktivitetet: 20,000,000 lekë, i ndarë sipas aktiviteteve kryesore:

- Festa e Drashovicës: 800,000 lekë
- Tetori Rozë: 1,200,000 lekë
- Traditë, Kulturë, Shije Delvinjote: 1,200,000 lekë
- Festivali i Melodive Qytetare: 1,500,000 lekë
- Promovimi i Qarkut (Vera, Ulliri, platforma promovuese): 8,000,000 lekë
- Festivali Folklorik "Këndojmë Flamurit": 3,000,000 lekë
- Festivali "Sol International Music" në bashkinë Himarë: 1,500,000 lekë
- Aktiviteti "Color Wave": 2,000,000 lekë
- Christmas Market, bashkia Himarë: 800,000 lekë

Shpenzime të tjera

- Shpenzime për qira zyre në Sarandë: 600,000 lekë.
- Shpenzime për këshilltarë: 1,250,000 lekë, në mbështetje të nenit 72, pika 5 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Shpenzimet për pritje-përcjellje: 100,000 lekë.
- Shpenzime për kontrata shërbimi: 400,000 lekë.
- Shpenzime për hartim të planit social: 5,000,000 lekë.
- Shpenzime për komisione Ad-Hoc: 400,000 lekë, në mbështetje të VKM për Komisionerin e Shërbimit Civil.

Shpenzime gjyqësore

- Shpenzime për detyrimet dhe kompensime legale: 1,000,000 lekë.
- Shpenzime gjyqësore: 200,000 lekë.

Shpenzimet për investime.

Në këtë buxhet, shpenzimet për investime janë parashikuar në shumën **91,170,180 lekë**, që përbën **52% të buxhetit total**, pa përfshirë funksionet e deleguara.

Investimet përfshijnë:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

1. Ndërtimi i kullave të vrojimit në Parkun Kombëtar Vjosë-Nartë
 - Vlera: 2,187,270 lekë
 - Ky investim mbështetet në Planin Strategjik dhe në Udhëzuesin Strategjik 6 "Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe peisazhit"
 - Projekti është tenderuar në shtator 2018, por mbeti i parealizuar për shkak të vonësës së lejes së ndërtimit.
2. Rikonstruksion i sallës së mbledhjeve të Këshillit të Qarkut
 - Vlera: 3,620,812 lekë
 - Projekti është detajuar dhe depozituar pranë Zyrës së Financës.
3. Studim-projektim
 - Vlera: 5,000,000 lekë
 - Ky studim është një kërkesë e anëtarëve të Këshillit të Qarkut, ngritur në mbledhjen e muajit shtator 2024.
4. Ndërtimi i pedonales pranë urës së Bratit
 - Vlera totale: 41,000,000 lekë (investim i shtrirë në dy vite)
 - Vlera për vitin 2025: 22,325,287 lekë
 - Investimi është bazuar në kërkesën dhe projektin e ardhur nga Bashkia Selenicë (nr. prot. 2553, datë 16.11.2023).
5. Rikonstruksion i rrugëve fshati Alihan, Bashkia Vlorë
 - Vlera: 39,000,000 lekë
 - Ky investim është bazuar në kërkesën dhe projektin e depozituar nga Bashkia Vlorë.
6. Rikonstruksion i fushës së futbollit, fshati Bamatat, Bashkia Delvinë
 - Vlera: 15,000,000 lekë
 - Investimi është bazuar në kërkesën e Bashkisë Delvinë (nr. 1416/02, datë 03.12.2024).
7. Rikonstruksion i këndit sportiv dhe këndë lojërash, fshati Aliko, Bashkia Finiq
 - Vlera: 4,036,811 lekë
 - Investimi është bazuar në kërkesën e Bashkisë Finiq (nr. 1416/03, datë 04.12.2024).

Ky plan investimesh synon të adresojë:

1. Nevojat infrastrukturore të qarkut, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonave.
2. Zhvillimin e hapësirave komunitare përmes ndërtimit dhe rikonstruksionit të ambienteve sportive dhe rekreative.
3. Përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe urbanistike, duke mbështetur projektet prioritare të bashkive përbërëse të qarkut.

Investimet e parashikuara janë në përputhje me:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Standardet e menaxhimit të financave publike sipas ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Objektivat strategjike të Këshillit të Qarkut Vlorë, të përcaktuara në planin zhvillimor për vitin 2025.

	BUXHETI 2025
Planifikimi i "Shpenzimeve Kapitale" për vitin 2025 (Llog. 230-231 - Investime)	
	<i>Vlera e planimeve</i>
Ndërtimi i kullave të Vrojtimit në Lagunën e Nartës	2,187,270
Ndërtim pedonale pranë ures së Bratit, bashkia Selenice	22,325,287
Rikonstrukcion i rrugës Aliban, Njesia Administrative Novosele, bashkia Vlorë	39,000,000
Rehabilitim i fushës së futbollit, fshati Bamatat, bashkia Delvine	15,000,000
Rikonstrukcion i kenderit sportiv dhe kende lojërash në fshatin Aliko, bashkia Finiq	4,036,811
Studim projektim	5,000,000
Rikonstrukcion i sallës së mbledhjeve dhe ambjentëve të Këshillit të Qarkut	3,620,812
TOTALI	91,170,180

Transferrat e Parashikuara shoqata të ndryshme, etj (604-605)

Shoqata e të Verhërve			250,000
Shoqata e Qarqeve			250,000
Transferti Bashkia Konispol (kërkese nr 1416/01) prot. 03.12.2024			19,958,500
Euro rajonet (AER) - Adriatiko Jonian (AJE) - CPMR			500,000
TOT			20,958,500

❖ **Detyrimet e Prapambetura nga viti 2024**

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Lubrina", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

DETYRIMET E PRAPAMBETURA NGA VITI 2023		
Emërtimi	Shuma e Propozuar	Mbatur
Ndërtimi i kufijve të Vrojtimit në Lagunën e Nartës Kodi i projektit	2,187,270	2,187,270
		2,187,270

Referencat ligjore mbi të cilat është hartuar buxheti i vitit 2025 për Këshillin e Qarkut Vlorë

1. **Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar**

- o **Neni 8:** Përcakton ushtrimin e autoritetit me interes publik.
- o **Neni 38, pika 3:** Një nga burimet kryesore të financimit të Qarkut është kuota e anëtarësisë së bashkive përkatëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive me vendim të Këshillit Bashkiak.
- o **Neni 41:** Përcakton parimet kryesore të hartimit të buxhetit lokal, duke përfshirë balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- o **Neni 72:** Përcakton që anëtarët e Këshillit të Qarkut kryejnë funksionin pa shpërblim, përveç anëtarëve të kryesisë së Këshillit të Qarkut.

2. **Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar**

- o Ky ligj përcakton parimet dhe procedurat për përgatitjen, miratimin dhe ekzekutimin e buxhetit në nivel vendor.

3. **Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"**

- o Rregullon financimin dhe administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel vendor.

4. **V.K.M. nr. 503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në V.K.M. nr. 328, datë 31.05.2023, për caktimin e kufijve të pagave për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

5. V.K.M. nr. 604, datë 14.09.2022 "Për ndryshimet në V.K.M. nr. 167, datë 29.03.2006, lidhur me zbatimin e ligjit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".
6. V.K.M. nr. 1198, datë 13.12.2009 dhe ndryshimet përkatëse "Për dietat dhe trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me:
- V.K.M. nr. 228, datë 13.04.2001,
 - V.K.M. nr. 870, datë 14.12.2011,
 - Udhëzimin nr. 22, datë 10.07.2013.
7. V.K.M. nr. 54, datë 05.02.2014, të ndryshuar, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".
8. Ligji nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian për asistencën në kuadër të instrumentit të para-aderimit (IPA)".
9. Ligji nr. 137/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA Greqi-Shqipëri 2014-2020".
11. Ligji nr. 10332, datë 14.10.2010 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare për programin ndërkufitar Shqipëri-Greqi për vitin 2009".
12. Vendimi nr. 503, datë 1 gusht 2024, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Përmbledhje

Buxheti i Këshillit të Qarkut për vitin 2025 është hartuar në përputhje me kornizën ligjore të Republikës së Shqipërisë, duke garantuar:

1. Përputhjen me ligjet aktuale për vetëqeverisjen vendore dhe financat publike.
2. Balancën midis të ardhurave dhe shpenzimeve, në respekt të dispozitave të ligjeve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

3. Parashikimin dhe përdorimin e fondeve të transferuara sipas rregullave të përcaktuara nga qeveria qendrore dhe ligjet përkatëse.

Grupi i punës:

Harallamb Pandehi

Anisa Hyseni

Mauricio Pashaj

Alma Myrtaj

Blerina Lula

Anisa Shametaj

Ilda Lamaj

Muhedin Bego